



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr. 4044 prot.

Fushë-Arrëz, më 23.10.2024

Informacion

Mbi ndryshimet ne Vkm Nr 408 date 13.05.2015“Per Miratimin e Rregullores se Zhvillimit te Territorit”

Bazuar ne ligjin Nr 107/2014 “Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, neni 27 pika 2(Autoritetet vendore pergjegjese per zhvillimin e territorit) , neni 29 pika a(detyrat e Kryetarit te Bashkise), ne Vkm Nr 408 date 13.05.2015 “Per Miratimin e Rregullores se Zhvillimit te Territorit”, neni 2 pika 10/7, neni 11/3(procedure e thjeshtuar per pajisjen me leje ndertimi per objektet njefamiljare ne zonat rurale), Autoriteti Vendor i Zhvillimit te Territorit (Kryetari i Bashkise), miraton projektet TIP per objekte njefamiljare dhe ne funksion te tyre kemi:

A-Subjekti aplikon ne e-Albania per leje ndertimi, me keto dokumente:

- 1-Formular aplikimi sipas formatit per projektin TIP.
- 2-Dokument qe verteton te drejtat e pronesise apo te drejta te tjera te ligjshme mbi pasurine ku do te realizohen punimet, ne se ka, ose deklarate pergjegjese qe verteton qe eshte i gatshem te zgjidhe çdo problematike qe mund te linde per pronesise apo kufitare, ne zona ku nuk eshte realizuar regjistrimi sipas ligjit.
- 3-Deklarate pergjegjese te plote civile dhe penale per vertetesine e dokumentacioneve te pronesise si dhe realizimin e punimeve ne perputhje me projektin e miratuar dhe legjislacionin qe rregullon veprimtarine e ndertimit ne Shqiperi duke perfshire mbrojtjen nga zjarri dhe kushtet higjieno –sanitare.
- 4-Leja e ndertimit jepet me kushtin qe objekti te ndertohet vetem sipas projektit TIP te miratuar.
- 5-Leja e ndertimit sipas modelit TIP, perjashtohet nga tarifat.

B-Autoriteti vendor i zhvillimit pergatit keto dokumenta:

- 1-Planvendosje te objektit te firmosur nga topograf te licensuar apo nga njesia vendore e zhvillimit.
- 2-Projektin TIP te zbatimit(te miratuar nga autoriteti vendor i zhvillimit) te firmosur nga projektues te licensuar apo projektues nga njesia vendore e zhvillimit.
- 3-Grafikun e realizimit te punimeve te firmosur nga projektues te licensuar apo projektues nga njesia vendore e zhvillimit.

C-Afati i dhenies se lejes se ndertimit eshte 30 dite nga data e aplikimit

D-Per dhenien e certifikates se perdorimit subjekti aplikues nuk eshte i detyruar te bashkelidhe ne kerkese per aplikim, aktin e supervizionit dhe te kolaudimit por vetem nje deklarate pergjegjesie nga ndertuesi qe punimet jane sipas projektit TIP te zbatimit ne kete rast.

E-Banese nje familjare sipas legjislacionit ne fuqi nenkupton nje objekt me siperfaqe ndertimore nga 30m2 per nje person sipas formule: $(S=20+N \times 10m^2)$, ku N =numri i pjestareve ne familje)deri ne 250m2 dhe sipas PPV-se se miratuar me Vendim te KKT-se Nr 4 date 15.04.2021, numri i kateve qe do te kene objektet per banim variojne nga 2-3 kate per zonat rurale.

F-Afati maksimal ku autoriteti vendor i zhvillimit te territorit duhet te miratoje projektet TIP per banesat nje familjare eshte data 12.12.2024, kjo sipas nenit 45 pika 2 e Vkm Nr 408 date 13.05.2015 "Per Miratimin e Rregullores se Zhvillimit te Territorit".

Pergatiti

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit

Ing.Tonin PRENGA

